

Termtat e Referencës

Organizata	HandiKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës)
Qëllimi i Angazhimit	Krijimi i manualit të Procedurave për Qendrat me bazë në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara në komunën e Gjakovës dhe Ferizajit
Lokacioni	Prishtinë, Kosovë
Kohëzgjatja	Qershor 2018
Data e pritshme e fillimit	Menjëherë

Informata të përgjithshme

Shoqata e Paraplegjikëve dhe Fëmijëve të Paralizuar të Kosovës (këtu e tutje HandiKOS) është themeluar në vitin 1983 me objektivin kryesor për të arritur njohjen dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. HandiKOS aktivisht lobon për dhe mbron në nivel lokal dhe qendror të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. HandiKOS, në kuadër të projektit "Shërbimet e bazuara në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara", i cili realizohet në partneritet me Save the Children Zyra në Kosovë me financim nga MACP Amerikan, ka për qëllim që në të dy Qendrat e HandiKOS-it në Gjakovë dhe Ferizaj të krijojë një manual të punës ku do të pasqyrojë strukturën dhe funksionimin e Qendrave, llojet e shërbimeve dhe aktiviteteve që ofrohen, strukturën e përfituesve dhe rëndësinë e shërbimeve që ofrohen në Qendrat me bazë në komunitet.

Objektiva

HandiKOS kërkon të angazhojë një kompani ose ekspert të lincensuar në ofrimin e trajnimeve për Hartimin e një Manuali i cili do të përmbajë rregullat rreth ofrimit të shërbimeve cilësore dhe të standardizuara për përfituesit (fëmijët me aftësi të kufizuara), si dhe do të përfshijë procedurat e punësimit, vlerësimit të punës, të drejtat e punonjësve, privilegjet dhe përgjegjësitë, praktikat e administrimit dhe dokumentimit të informacionit profesional, si dhe të marrëdhënieve me palët e treta në Qendrat e HandiKOS-it në komunën e Gjakovës dhe Ferizajit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të zhvillojë një Manual (doracak) i cili do të inkorporojë rregullat që mundësojnë ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të standardizuara për fëmijët me aftësi të kufizuara - përfitues të shërbimeve në Qendrat e HandiKOS në komunën e Gjakovës dhe Ferizajit.
- Manuali (doracaku) në vete duhet të përmbajë informacione dhe përshkrimet përkatëse

mbi:

- Proceset e administrimit të Qendrës;
- Parimet e përgjithshme të punës së Qendrës;
- Procedurat e secilit shërbim që ofron Qendra (kriteret për përfitim nga shërbimi i caktuar, kur fillon dhe përfundon shërbimi etj.);
- Praktikat e mira të menaxhimit të Qendrës nga ana e stafit;
- Procedurat e rekrutimit të stafit të Qendrës;
- Kodin etik për stafin, në raport me përfituesit e shërbimeve dhe kolegët;
- Përgjegjësitë e menaxhmentit të stafit lidhur me ofrimin e shërbimeve;
- Përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësiave të stafit (Menaxherit të Qendrës, Punonjësit social, Psikologut, Edukatorit, Terapistit të folurit/Logoped, Terapistit okupacional);
- Praktikat për monitorimin dhe vlerësimin e performancës së stafit;
- Procedurat e promovimit të shërbimeve;
- Mënyrat e menaxhimit të të dhënave të përfituesve (arkivimi dhe rregullat e qasjes së përfituesve në të dhëna);
- Procedurat e raportimit mbi punën (Mujore, 6 mujore apo 1 vjeçare) të Qendrës ;
- Të drejtat dhe detyrimet e përfituesve të shërbimeve brenda dhe ndaj Qendrës;
- Kriteret për tu pranuar si përfitues/përdorues i shërbimeve të Qendrës
- Procedurat për pranimin dhe trajtimin e ankesave nga përfituesit dhe stafi;
- Procedurat për periudhën kalimtare dhe përfundimin e shërbimeve për përfituesit e Qendrës;
- Ambientit të jashtëm dhe të brendshëm të Qendrës – me specifika për ofrimin e shërbimeve.

Kohëzgjatja dhe pritjet

Konsulenca është planifikuar të zgjasë prej me 08 deri me 30 Qershor, me një angazhim prej 10 ditë pune, gjatë të cilave pritjet:

- a) Zhvillimi i intervistave dhe takimeve me stafin e qendrave me bazë në komunitet në komunën e Gjakovës dhe Ferizajit, për identifikimin e procedurave të nevojshme të cilat do të jenë pjesë e Manualit;
- b) Identifikimi dhe hulumtimi i modeleve dhe Procedurave Standarde në rajon mbi ofrimin e shërbimeve në qendra me bazë në komunitet;
- c) Fasilitimi i punëtorisë së parë me stafin e dy Qendrave të HandiKOS-it në komunën e Gjakovës dhe Ferizajit dhe palët tjera të interesit, për të prezentuar qëllimin dhe modelet e përdorura në hartimin e Manualit;
- d) Fasilitimi i punëtorisë së dytë me stafin e dy Qendrave të HandiKOS-it në komunën e Gjakovës dhe Ferizajit dhe palët tjera të interesit, për të prezentuar përmbajtjen finale të Manualit;
- e) Dorëzimi i Draftit final të Manualit të HandiKOS dhe Save the Children.

Kualifikimet dhe eksperiencia

- Përvojë në zhvillimin e udhëzuesve/protokolleve/mjeteve të dedikuara për ofruesit e shërbimeve me bazë në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara në veçanti;
- Diplomë Universitare në departamentin e Pedagogjisë apo Psikologjisë, apo fushë të ngjashme në shkencë sociale (kualifikimi Master dhe edukimi profesional/joformal në këtë fushë është përparësi);
- Njohuri të çështjes së aftësisë së kufizuar në kontekstin vendor;
- Shkathtësi të larta hulumtuese në identifikimin e praktikave/modeleve të cilat përdoren në rajon dhe botë në këtë fushë;
- Shkathtësi të larta fasilituese në zhvillimin e punëtorive dhe takimeve;
- Shkathtësi ndër personale dhe të komunikimit;
- Ndjeshmëri ndaj kontekstit dhe situatave të ndryshme me qasje të hapur ndaj diversitetit;
- Njohuri për parimet e të drejtave të fëmijëve të bazuara në KDF dhe KB;
- Shkathtësi të larta në të shkruar dhe të folur të gjuhës shqipe dhe angleze.

Angazhimi i Kompanisë/Ekspertit/es:

Kompania/Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HandiKOS- nën koordinimin e Kordinatorit të Projektit. Në këtë kontratë do të përcaktohen në mënyrë specifike pikat të cilat nuk janë të përfshira në këtë dokument

Kushtet e Pagesës:

Pagesa e kompanise/ekspertit/es do të bëhet sipas faturës përkatëse për kryerjen e shërbimeve. Pagesa do të realizohet përmes transaksionit bankar në valutën Euro, pas përfundimit me sukses të angazhimit dhe aprovimit të produktit përfundimtar dhe raportit të punës të aprovuar nga HandiKOS.

Procedurat e aplikimit

Aplikuesit duhet të dorëzojnë

- Një draft propozim mbi metodologjinë e punës për këtë angazhim, përfshirë planifikimin e procesit të zhvillimit të dokumenteve përkatëse;
- Një letër interesi që paraqet arsyet që ai/ajo është i/e përshtatshëm dhe ka njohuri dhe eksperiencë në fusha të ngjashme;
- Ofertën financiare për koston e këtij angazhimi;
- Curriculum Vitae (CV).

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në emailin: behxhet.binaku@handi-kos.org me subjektin *Aplikacioni për Aneksin e PSVs*. Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 06 Qershor 2018, deri në ora 12:00.